



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11, dhe 17 shkronja k) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për caktimin e kriteve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01-006-26348 të datës 30 mars 2016, neneve 14 dhe 19 paragrafi 1.11 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, sipas kërkesës me nr.prot.293/20 të datës 09.10.2020 të Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, miratoi,

### **VENDIM**

#### **PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET E VARRIMIT TË QYTETARËVE ME VENDBANIM TË PËRHERSHËM NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS**

##### **Neni 1**

Komuna e Podujevës, për qytetarët me vendbanim të përhershëm përkatësisht personat që vdesin dhe varrosen në territorin e saj, bënë subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit për periudhën deri më 31.12.2022.

##### **Neni 2**

1. Për çdo person të vdekur për të cilin në bazë të ekzaminimeve mjekësore në pajtim me dispozitat ligjore është konstatuar vdekja, bëhet subvencionimi i shpenzimeve për shërbimet e varrimit nga Bashkësia Islame përkatësisht Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë, që përfshijnë: transportin e kufomës, fletëljajmrimet (afishet), dërrasat, piramidën, pastrimin e kufomës, mbulesën e kufomës dhe qefin.

2. Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë kërkesës për kompensim të shërbimeve përkatëse sipas çmimores, i bashkëngjit edhe konstatimin e vdekjes nga mjeku, dhe raportin e kryerjes së shërbimeve të vërtetuar – nënshkruar edhe nga ndonjëri prej familjarëve të ngushtë të të vdekurit (kopja ose numri i letërnjoftimi).

##### **Neni 3**

Autorizohet Kryetari i Komunës, përkatësisht Nënkyetari i Komunës së Podujevës në cilësinë e ushtruesit të detyrës dhe kompetencës së Kryetarit të Komunës së Podujevës, të lidhë marrëveshje mirëkuptimi me Këshillin e Bashkësisë Islame në Podujevë, në cilësinë e subjektit të vetëm për ofrimin e shërbimeve sipas këtij vendimi, përmes së cilës definohen më në detaje obligimet dhe përgjegjësitë.

##### **Neni 4**

Subvencionimi bëhet nga mjetet buxhetore përkatësisht të hyrat vetanake – kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

### **Neni 5**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është çmimorja e shërbimeve.

### **Neni 6**

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorinë e Administratës.

### **Neni 7**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ndërsa fillon të zbatohet nga 01 janar 2021.

**Nr. 01-104/02-0065932/20**

**Podujevë,  
30 tetor 2020**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Patmir Gashi**

